



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 13/11

Prishtinë, më 02.06.2011, ora 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi: Safete Hadërgjonaj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-Ministër i Financave, Agim Krasniqi, Lulzim Rafuna dhe nga MEF, Teki Shala, Juergen Schatz dhe Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 04.05.2011 dhe 11.05.2011;
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2012-2014
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. Shqyrtimi i Konventës për Themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010
I ftuar: Osman Ejupi, Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta;
7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditimin, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.
Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, më datë 04.05.2011 dhe 11.05.2011

Albana Fetoshi, theksoi se në procesverbalin e 11.05.2011, figuron emri i saj në listën e pjesëmarrësve në mbledhje të komisionit, ndërsa ajo nuk ka marrë pjesë në mbledhje.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalet miratohen me vërejtjen e znj. Fetoshi.

3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2012-2014

Bedri Hamza, theksoi se ky dokument është zhvilluar në dy skenarë: skenari bazë që është më konservativ në mënyrë që me rastin e planifikimit të të hyrave të mos paraqiten vështirësi, si dhe skenari i bazuar në zhvillimin ekonomik, që ka si objektiv rritjen ekonomike deri në 7%. Skenari i zhvillimit ekonomik do t'i përcaktojë politikat ekonomike dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre politikave. Kur këto politika fillojnë të imlementohen, atëherë ato do të bëhen pjesë e skenarit bazë dhe pjesë e parashikimeve tona të të hyrave buxhetore. Parashikimet e çmimeve në skenarin bazë tregojnë një normë të inflacionit prej 5.3% në vitin 2011 dhe një normë mesatare prej 1.7% gjatë viteve 2012-2014. Projektionet e të hyrave buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë makroekonomikë, duke përfshirë këtu lëvizjet e importit, çmimet si dhe vlerësimet mbi rritjen e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave siç janë doganat dhe ATK-ja. Në përgjithësi të hyrat totale deri në fund të vitit 2014 priten të arrijnë deri në 1.431.000.000 € ose një rritje prej 13%, ndërsa të hyrat tatimore priten të arrijnë shumën prej 1.243.000.000 € ose një rritje prej 17%. Rritja mesatare e të hyrave të përgjithshme buxhetore për periudhën e parashikuar 2012-2014 pritet të jetë rreth 4.3%, të cilat parashikime burojnë nga skenari bazë. Shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës 2012-2014 pritet të shënojnë një ngritje të vazhdueshme duke arritur një vlerë prej 1.487.000.000 €, ose një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2011. Rritja e shpenzimeve pritet të jetë më e shpejtë se sa e të hyrave, gjë që do të ndikojë në krijimin e deficitit primar për periudhën e planifikuar. Pas përfundimit të autostradës Ibrahim Rugova, niveli i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore do të zvogëlohet, sepse parashihet që projektet e mëdha kapitale të financohen përmes partneriteteve publiko-private. Sipas kësaj mesatarja e deficiteve gjatë vitit 2012-2014 do të jetë rreth 2.1% e BPV të planifikuar.

Hykmete Bajrami, theksoi se KASH-i, në shikim të parë duket optimist, ku flitet për zvogëlim të papunësisë prej 7-8% në baza vjetore, që do të thotë se Qeveria do të krijojë 5.500 vende të reja të punës çdo vit duke pasur parasysh 330.000 numrin e të papunëve që është akumuluar dhe rreth 25.000-30.000 që hyjnë në tregun e punës çdo vit. Si rezultat i shkëputjes së marrëdhënieve

kontraktuale të FMN-së me Kosovën, Kosova ka humbur 156.000.000 €, edhe pse kjo shumë e mjeteve figuron ende në dokumentin e KASH-it dhe kjo do të reflektojë vështirësi edhe në integrimin në institucionet tjera ndërkombëtare financiare. Në KASH janë integruar disa prej objektivave të vizionit të planit për zhvillim ekonomik që është mbajtur në Bullgari, ku përfshihen përmirësimi i ambientit të biznesit, arritjen në top 40-shin e reformatorit deri në vitin 2014, mirëpo kjo nuk do të thotë se do të kemi rritjen e investimeve të huaja. Gjithashtu nuk ceket që eliminimi i disa licencave dhe procedurave administrative duhet të jenë patjetër në bashkëpunim me nivelin lokal. Dha vërejtje për subvencionet në bujqësi të cilat përveç që janë të ulëta, ato po jepen edhe me vonësë. Edhe liberalizimi i vizave duket të jetë optimist. Te mirëqenia sociale thuhet se kemi 325.000 qytetarë, mirëpo sugjeroi se duhet të jenë për familje. Edhe inflacioni po duket shumë optimist, përderisa në jetën reale është shumë më i lartë.

Muhamet Mustafa, konsideroi që ky dokument e obligon Qeverinë dhe nuk duhet të dilet jashtë kornizave të këtij dokumenti, mirëpo ende ka nevojë për përmirësime. Sugjeroi që Ministria e Financave duhet edhe një herë ta rishikojë këtë dokument para se ta dërgojë në seancë plenare, duke theksuar dy arsye: e para është se në këtë dokument janë dy skenarë të cilat dallojnë shume me njëri-tjetrën dhe duhet të dimë se për cilin skenar është Qeveria, duhet që brenda një kohe Ministria dhe Qeveria të harmonizohen dhe të vijnë me një skenar në komisioni, për të parë se sa është ai skenar i mbështetur në politikat dhe projektet që do të na sjellin rritje ekonomike mbi 7%. E dyta është se ka ndodhur diçka e rëndësishme e cila nuk ka qenë e papritur siç ndodhi me FMN-në dhe sipas kësaj tabela 3 faqe 51 ka nevojë për një ristrukturim. Duhet t'i shohim veprimet e Qeverisë për rirregullimin e marrëdhënieve me FMN-në në vitin 2012 për t'i përfituar ndihmat dhe grantet nga FMN-ja të cilat janë të domosdoshme. Ai theksoi që ulja e papunësisë 8-10% është e pamundur, gjithashtu kërkoi një dokument që sjell me të vërtetë një rritje ekonomike prej 7% duke u bazuar në të dy skenarët. Duhet parë se çka qëndron prapa investimeve private që janë gjeneratori kryesor, edhe pse investimet ende janë shumë të shtrenjta. Kërkoi që në prezantim prioritetet të shprehen në përqindje.

Bedri Hamza, theksoi se KASH-i është një dokument i cila ka nevojë vazhdimisht për rifreskim në mënyrë që t'i përshtatet realitetit, pasi që nuk është një dokument statik. Sa i përket shkëputjes së marrëdhënieve me FMN-në sqaroi që Kosova ka lidhur një marrëveshje me FMN-në në vitin 2010, për 18 muaj që ka pasur të bëjë me mandatin e plotë të Qeverisë së kaluar. Kosova ka pasur përafrim të qëndrimeve sa i përket çështjes së pagave, por jo harmonizim të plotë. Gjatë vizitës së fundit që ka pasur FMN-ja në Kosovë, është bërë një marrëveshje e quajtur si program i monitoruar i stafit deri në fund të vitit 2011, i cili do t'i ketë dy rishikime në vjeshtë, në fund të vitit apo në fillim të vitit të ardhshëm. Nëse rishikimet në vjeshtë që planifikohen të vlerësohen pozitivisht, Banka Botërore do t'i derdhë fondet në buxhetin e Kosovës për vitin 2011. Kosova nuk i ka humbur mjetet, por kemi një prolongim të afatit, pasi që duhet të respektohen kriteret e marrëveshjes, sepse këto mjete nuk janë donacion, por është kredi. Kreditë që i jep FMN-ja nuk janë kredi investive, por janë për ruajtjen e likuiditetit dhe ky borxh hyn në kuadër të borxhit publik. Çështja e pagave është kapitull i mbyllur, për të cilin nuk do të diskutohet në të ardhmen. Zbutja e papunësisë 8-10% dhe rritja ekonomike prej 7% duhet të rishikohen për të parë se sa korrespondojnë këto shifra me njëra-tjetrën. Rangimi në mesin e dyzet vendeve më të lehtë për të bërë biznes është dëshirë e të gjithë neve, por natyrisht me një bashkëpunim më të thellë me nivelin lokal. Ministria po bën përpjekje që ta rrisë buxhetin e bujqësisë, por nuk favorizojmë dhënien e subvencioneve, sepse nuk e përmbajnë elementin kthyes. Liberalizimi i vizave është çështje politike. Te mirëqenia sociale kemi të bëjmë me përfitues të cilët janë edhe familje, edhe individë. Ai sqaroi se do të inkorporohet skenari bazë, por ka projekte të cilat nuk varen nga institucionet e Kosovës. Çështjet për ndarje sektoriale dhe shprehja në përqindje, gjithsesi do të merren në konsiderim.

Kryesuesi, theksoi që është një dokument themelor, por natyrisht që ka nevojë për rishikim në mënyrë që të kemi një buxhet më të qëndrueshëm për interesa të Kosovës. Sipas procedurave ligjore, ky dokument nuk aprovohet.

Komisioni pas diskutimeve, njëzëri nxori:

R E K O M A N D I M

- I. Të shqyrtohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2012-2014, në seancën plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor

Kryesuesi, theksoi se qëllimi i Konventës është hapja e rrugës për anëtarësim të Doganave të Kosovës në mekanizmin e rëndësishëm botëror, siq është Organizata Botërore e Doganave. Kostoja shtesë buxhetore e miratimit të kësaj Konvente parashihet të jetë rreth 25.000 € në vit, të cilat mjete do të përdoren për pagesën e anëtarësimit të Doganave të Kosovës në këto institucione të rëndësishme.

Bedri Hamza, sqaroi se sipas kësaj Konvente kërkohet deponimi paraprak i instrumentit të ratifikimit të Konventës për Bashkëpunimin Doganor, i cili duhet të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Belgjikës, e cila pastaj do ta dorëzojë tek Organizata Botërore e Doganave. Anëtarësimi i Doganave të Kosovës në këtë Organizatë Botërore ka rëndësi relevante, në veçanti duke pasur parasysh përfitimet e shumëfishta në zhvillimin e standardeve globale, zinxhirin e furnizimit të sigurisë së tregtisë, lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, përmirësimin e aktiviteteve në pajtueshmëri me doganat tjera anëtare, partneritetin publiko-privat si dhe një sistem të qëndrueshëm doganor global.

Albana Fetoshi, përkrahu Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor, mirëpo ngriti shkelet sovranitetit të Kosovës, përmes pikave doganore 1 dhe 31, ku kontrabandohen mallrat e Serbisë, dhe të gjitha këto tolerohen nga Qeveria e Kosovës. Kodi doganor nuk respektohet në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit, të ratifikojë Konventën për Themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010

Osman Ejupi, sqaroi se gjatë vitit 2010 janë përdorur fondet buxhetore me korrektësi në të gjitha kategoritë. Prezentoi shkurtimisht pjesën financiare të raportit vjetor të KKK-së për vitin 2010, i cili raport i është dorëzuar Kuvendit.

Albana Fetoshi, sipas nenit 20.2 të Ligjit të Konkurrencës KKK-ja duhet të ketë personel të mjaftueshëm në mënyrë që t'i kryej punët sa më profesionalisht, mirëpo sipas raportit po shihet që numri i të punësuarve nuk është edhe aq në nivel, konkretisht në departamentin juridik është vetëm një i punësuar përderisa departamenti është i ndarë në dy sektorë, lidhur me këtë pyeti se apo keni vështirësi në këtë drejtim? Edhe një çështje tjetër e theksoi që sipas nenit 3 të Ligjit të Konkurrencës

mbi marrëveshjet të cilat mund të ndikojnë negativisht në tregtinë e brendshme të Kosovës, ku prej tri rasteve, dy janë kryer me sukses, ndërsa për marrëveshjen tjetër që ka pasur të bëjë me shfuqizimin me vendim të marrëveshjes verbale në mes të pronarëve të pompave të derivateve të naftës në rajonin e Gjilanit për caktimin dhe nivelizimin e çmimeve të derivateve të naftës, pyeti pse nuk është sanksionuar kjo marrëveshje apo është hetuar aq shpejt sa që nuk ka shkaktuar ndonjë dëm shumë të madh të konsumatorët dhe sa është periudha e zbatimit në praktikë e kësaj marrëveshjeje?

Hykmete Bajrami, pyeti për masat monitoruese që ndërmerren për prishjen e një marrëveshjeje si dhe kërkoi një opinion nga kryetari i KKK-së lidhur me atë se në kohën e fundit është vërejtur që çmimi i karburanteve dallon shumë në pjesën veriore të Mitrovicës në krahasim me pjesën tjetër të Kosovës, a ndërmerrni ju diçka në këtë aspekt?

Osman Ejupi, pranoi që KKK-ja nuk ka staf të mjaftueshëm si pasojë e mungesës së hapësirës, pasi që ajo e kryen veprimtarinë vetëm në dy zyre, mirëpo sipas organogramit të personelit në mund t'i marrim edhe gjashtë shërbyes civilë nga dy për tri departamentet që janë në KKK. Lidhur me gjobat, sqaroi se KKK-ja ka dhënë dymbëdhjetë gjoba, prej tyre dhjetë kanë qenë për kompanitë e sigurimeve dhe dy kanë qenë për kompanitë që merren me mirëmbajtjen e arkave fiskale. Në pyetjen pse nuk i keni gjobitur naftarët, u përgjigj se kjo ka ndodhur për shkak se naftarët nuk kanë qenë të njoftuar sa duhet me Ligjin për Konkurrencën dhe kemi menduar që në mundemi t'i edukojmë ata me masat parandaluese duke i mbajtur disa seanca dëgjimore. Sa i përket monitorimeve të naftarëve, sqaroi se KKK-ja çdo muaj i merr çmimet e derivateve të naftës në terren dhe në bazë të këtyre indekseve mundohemi të monitorojmë tregun. Për pjesën veriore sqaroi se pikat 1 dhe 31 e destabilizojnë gjithë tregun e derivateve të naftës dhe lidhur me këtë opinionin i KKK-së ka qenë që të bëhet fiskalizimi strikt i të gjitha derivateve të naftës, por ky proces nuk ka arritur të implementohet akoma.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar për vitin 2010 i Komisionit Kosovar të Konkurrencës.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ndaj palëve të treta

7.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

- I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim, Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ndaj palëve të treta

8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

- I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim, Projektligjin për Akcizën në Produktet e Duhanit

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

1. Projektligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare, dhe amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditimin, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

1. Projektligji nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditimin, dhe amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

11. Të ndryshme

U diskutua për vizitën e Komisionit në Berlin që do të organizohet nga data 28 qershor deri më 01 korrik dhe u kërkuar që deri në mbledhjen e radhës të konfirmohet pjesëmarrja.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Naser OSMANI